

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	REL: BE-ja s'e komenton nismën për Specialen, thotë se vazhdon ta mbështesë Gjykatën në Hagë
ADRESA	https://dosja.al/aktualitet/rel-be-ja-se-komenton-nismen-per-specialen-thote-se-vazhdon-ta-mbesht-i515498
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 05:13:19 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	22 shtator 2026, 15:30:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	36cfab36a56d08e44890404c4c090546ce61197218b257b9c950632c022e5d09
TEKSTI	96e5fa48194ed391839f2c814291a347d7bc90b0c8946f021335126f78a86dce
PAMJA	ef5840f4f18891f6292b9ec2578eda5a0ba64ab78af27fd2f495453c8a451dfc

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	64bf0a7683a8888a21b6620ff1ed7a1df87e2f77eaea32bbcbd89a633c8d8109
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	4a111ad93b0774e4315d3f6f441e1591ae8aff5c47e01d9c0b726a490b4da86a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/64bf0a7683a8888a21b6620ff1ed7a1df87e2f77eaea32bbcbd89a633c8d8109>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

9 ORE ME PARE

115 ditë revoltë kundër qeverisë, qytetarët sërish në shesh: Arrestoni Ramën

13 ORE ME PARE

"Kam zgjidhur 8 luftëra"/ Trump në OKB: Falënderoj Shqipërinë e Kosovën, kanë dërguar dhe ofruar mbështetje ushtarake. Me Iranin o marrëveshje ose do ta asgjësoj

16 ORE ME PARE

"Kërkoj dorëheqjen urgjente të Ramës"/ Berisha: SPAK të lëshojë mandat arresti ndërkombëtar për Vlorë Hysenin

22 ORE ME PARE

Hetimet për skandalin me AKSHI-n/ SPAK kontrollon në banesën e Ilir Prodës, masë sigurie dhe për kreun e SHISH Vlorë Hyseni

Aktualitet

REL: BE-ja s'e komenton nismën për Specialen, thotë se vazhdon ta mbështesë Gjykatën në Hagë

Zëdhënësi i BE-së, Christian Wigand, përsëriti qëndrimin e bllokut evropian për mbështetjen për gjykatën dhe shtoi se Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar që njihen si Gjykata Speciale janë institucione të pavarura të drejtësisë që janë formuar nga Kuvendi i Kosovës më 2015.



22 Shtator 2026, 17:30
Nga G.M



Flamuj të BE-së. Fotografi nga arkivi.

Bashkimi Evropian tha se nuk komenton njoftimet apo planet, kur u pyet lidhur me nismën për ndryshimin e Ligjit për Dhomat e Specializuara të Kosovës, por një zëdhënësi i bllokut tha se Brukseli do të vazhdojë mbështetjen për gjykatën me seli në Hagë.

Zëdhënësi i BE-së, Christian Wigand, përsëriti qëndrimin e bllokut evropian për mbështetjen për gjykatën dhe shtoi se Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar që njihen si Gjykata Speciale janë institucione të pavarura të drejtësisë që janë formuar nga Kuvendi i Kosovës më 2015.

"Puna e tyre është e rëndësishme për të siguruar llogaridhënie, për t'u dhënë drejtësi viktimave dhe familjeve të tyre nga të gjitha komunitetet e Kosovës. Dhe, siç kam theksuar edhe më parë këtu, personat e dënuar me aktgjykimin e shkallës së parë, natyrisht, kanë të drejtë të apelojnë. Aktgjykimin do të shqyrtohet nga gjyqtarë të pavarur të apelit, në një panel të veçantë të apelit të Dhomave të Specializuara. Por, mbështetja jonë për Dhomat është e qëndrueshme dhe do të vazhdojë", tha ai.

Gjykata Speciale financohet nga Bashkimi Evropian, por edhe nga shtetet e treta kontribuuese, ku bëjnë pjesë Shtetet e Bashkuara, Kanadaja, Norvegjia, Zvicra dhe Turqia. Një ditë më parë, Partia Demokratike e Kosovës dorëzoi në Kuvendin e Kosovës një projektligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Dhomat e Specializuara.

PDK-ja tha se nisma vjen pas protestave të ditëve të fundit kundër aktgjykimin ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Më 16 shtator, ish-eporët e UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi u shpallën fajtorë për katër akuza për krime lufte. Të katërt, marrë së bashku, janë dënuar me 81 vit burgim.

editoriale

Eriseld Zeneli

Shqipëria, socializmi i Edi
Ramës pa të majtën

Irena Beqiraj

Kostot e jetesës edhe lajmi se
ekonomia po ecën mirë

Në vëmendje

AKTUALITET 22 SHTATOR 2026, 21:20

**Marshimi nëpër Tiranë,
efektivët bllokojnë lëvizjen e
protestuesve në hyrje të ish-
Blokut: Polici e krimit**

AKTUALITET 22 SHTATOR 2026, 18:16

**Masa e sigurisë ndaj Vlorë
Hysenit/ Reuters: BE po ndjek
nga afër mënyrën se si
autoritetet shqiptare trajtojnë
çështjet e korrupsionit**

PDK-ja ka thënë se ndryshimet e propozuara në ligj nuk nënkuptojnë zhbërjen e Gjykatës Speciale në Hagë. Në dokumentin që e ka parë Radio Evropa e Lirë, kërkohet ndër të tjera, që dënimet më të larta që mund të shqiptohen të jenë 15 vjet burgim dhe që të dënuarit të mund të jenë subjekt i faljes presidenciale.

Nisma ka gjetur përkrahjen e partisë politike, Aleanca, ndërkaq Lëvizja Vetëvendosje, ka thënë se do ta shqyrtojë kërkesën e PDK-së në aspektin juridik, përfshirë edhe përputhshmërinë e tij me kornizën ligjore në fuqi dhe "efektet që një ndërhyrje e tillë eventualisht mund të ketë në këtë fazë të procedurave pranë Dhomave të Specializuara".

Teksa nisma e PDK-së u dorëzua në Kuvend, në Kosovë çdo natë po mbahen protesta kundër vendimit të Speciales që nga akgjykimi i 16 shtatorit, ndërkaq është paralajmëruar edhe një marsh më 1 tetor nga platforma Liria ka Emër. Kjo platformë tha po ashtu se do të iniciohet edhe një peticion qytetarë, që do të dërgohet simbolikisht në Bruksel, Strasburg e Hagë.

Ndryshe, më 2015 deputetët e Kosovës votuan për të bërë ndryshimet kushtetuese që mundësuan krijimin e Gjykatës Speciale. Kjo gjykatë është brenda sistemit ligjor të Kosovës, por funksionon në Hagë me gjykatës dhe prokurorë ndërkombëtarë. Ajo heton krimet që pretendohet se janë kryer nga ish-pjesëtarët e UÇK-së nga janari i vitit 1998 deri në dhjetor të vitit 1999. Deri më tani, gjykata ka shqiptuar disa aktgjykime dënuese për krime lufte dhe për raste të pengimit të drejtësisë./REL

be hage rel

Sondazh

Poll

Aktualitet
22 Shtator 2026, 17:20

Vatër zjarri në Delisuf të Novoselës, digjet një sipërfaqe me pemëtari, zjarrfikëset në vendngjarje

zjarri në Delisuf të Novoselës VLORË- Një vatër zjarri e përmasave të mëdha është regjistruar ditë...

Vatër zjarri në kodrat e Pojanit në Fier, era përhap flakët, rrezikohet Parku Arkeologjik i Apolonisë

Aktualitet
22 Shtator 2026, 17:14

Aksidenti në Don Bosko, humb jetën

AKTUALITET 22 SHTATOR 2026, 11:28

FOTOT/ Ja kush janë efektivit dhe biznesmeni që u arrestuan në Durrës gjatë operacionit të SPAK

më të klikuarat

FOTOT/ Ja kush janë efektivit dhe biznesmeni që u arrestuan në Durrës gjatë operacionit të SPAK

Avokati Arben Llangozi rikthen video-dënoncimin: Agasi në kërkim udhëtonte me makinën Audi A8 të Vlora Hysenit

SPAK caktoi masën "arrest shtëpie"/ Rama shkarkon Vlora Hysenin: Drejtësia të bëjë punën e saj!

Shkëlqimi dhe rënia e Vlora Hysenit/ Kush është shefja e Shërbimit Informativ në masë sigurie nga SPAK. Në Kosovë e shkarkuan nga puna

insights

Rezarta Gagani
Përballë pallatit tim po ndërtohet një pallat

Auron Janku
Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Ola Xama
Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari
Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Moti

Powered by tomorrow.

drejtuesi 04-vjeçar i motorit

Aktualitet

22 Shtator 2020, 16:31

**Lufta kundër krimit të organizuar/
Ambasada amerikane: Kur SHBA dhe
Shqipëria qëndrojnë së bashku,
komunitetet tona janë më të sigurta**

Aktualitet

22 Shtator 2020, 16:14

**Ndërtim i paligjshëm e shpërdorim
detyrë/ Prokuroria Sarandë sekuestron
'Central Park Premium Hotel' dhe një
ndërtim tjetër pa leje, "arrest shtëpie" për
një person**

Aktualitet

22 Shtator 2020, 16:09

Aktualitet

22 Shtator 2020, 15:58

"Janë të paktën 11 varreza masive", Kosova synon gërmime të reja në Serbi

KOSOVË- Institucionet kosovare janë kthyer për kërkime në fshatin
Kozhle, në zonën e Novi Pazarit, në Serbi, ku dyshoh...

**Aksident në zonën e Don Boskos, makina
përplas motorin, plagoset drejtuesi**

Aktualitet

22 Shtator 2020, 15:11

**Sherr mes nxënësve në Krumbë/ 17-
vjeçari gërvisht me mjet prerës
bashkëmoshatarin në oborrin e
gjimnazit**

Aktualitet

22 Shtator 2020, 15:08

Përndiqte ish-të dashurën, arrestohet 33-vjeçari në Tiranë, kanosi edhe punëdhënësin e saj

Aktualitet


22 Shtator 2026, 13:41

Shkëlqimi dhe rënia e Vlora Hysenit/ Kush është shefja e Shërbimit Informativ në masë sigurie nga SPAK. Në Kosovë e shkarkuan nga puna

Aktualitet

22 Shtator 2026, 13:06

MË SHUMË



Zjarr masiv në Lalz, rrezikohen banesat, banorët në alarm

Zjarr me përmasa të mëdha në Lazarat, flakët rrezikojnë banesat

Aksident me vdekje në Lezhë, humb jetën 50-vjeçari

Berisha: Kadastrën e Vlorës e hëngri 'kuçedra' Edi Rama për pronat e tij!

Zjarr masiv në Lalz, rrezikohen banesat, banorët në alarm

Shiko video te tjera



KTHEHU NE KRYE



Dosja.al është një iniciativë gazetarësh të rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444

Email:



KONTAKT PRIVACY POLICY COOKIES

MEMBERSHIP INGA Mediasdesk

AKTUALITET

POLITIKE

EKONOMI

BOTA

SPORT

ART&ARGËTIM

INSIGHTS

EDITORIAL

Drejtör: Enton Abilekaj

Kryeredaktor: Izmir Akulli

Gazetarë:

Esmeralda Doçi

Emanuela Dida

Elisa Karaj

Dorotea Simoni